



Tribunal Constitucional



E hartuar në Madrid, më 05/03/2024

MIDIS GJYKATËS KUSHTETUESE TË MBRETËRISË SË SPANJËS

DHE GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Midis Shkëlqesisë së Tij, Z. Cándido Conde-Pumpido Tourón, Kryetar i **GJYKATËS KUSHTETUESE TË MBRETËRISË SË SPANJËS**, njëra prej palëve, dhe Shkëlqesia së Tij, Z. Holta Zaçaj, Kryetar i **GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, i palës tjetër, në emër dhe si përfaqësues të institacioneve të përmendura më lart.

TË PËRGJITHSHME

I. Duke marrë në konsideratë se Gjykata Kushtetuese e Mbretërisë së Spanjës është interpretuesi më i lartë (suprem) i Kushtetutës së Spanjës, e pavarur nga autoritetet e tjera kushtetuese të Shtetit dhe e udhëhequr vetëm nga Kushtetuta dhe ligji i saj organik. Ajo është gjykata e vetme e ligjit kushtetues në Spanjë, me juridikcion që shtrihet mbi të gjithë vendin. Gjykata Kushtetuese ka

autoritetin të kontrollojë kushtetutshmérinë e Akteve të Parlamentit dhe të ligjeve që janë ekuivalente me to, si dhe të shqyrtojë ankesat individuale për shkeljet kushtetuese në mbrojtje të të drejtave themelore dhe lirive publike, si dhe të konflikteve të juridikzionit ndërmjet qeverisjes qendrore të Spanjës dhe Komuniteteve të saj Autonome, apo ndërmjet vetë Komuniteteve Autonome. Gjithashtu, ajo ka juridikcion mbi çdo çështje tjetër që i është caktuar nga Kushtetuta apo ligji i saj organik.

II. Gjkata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Gjkata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës. Gjkata Kushtetuese ka buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur.

Gjkata Kushtetuese vendos për: a) pajtueshmérinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122; b) pajtueshmérinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre; c) pajtueshmérinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare; ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendor dhe qeverisjes vendore; d) kushtetutshmérinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute; dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij; e) çështjet që lidhen me zgjedhshmérinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre; ë) kushtetutshmerinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij; f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të

garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përvçese kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

III. Ndonëse modelet e tyre të kontrollit të kushtetutshmërisë dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore mund të kenë ndryshime të vogla, të dyja institucionet kanë të përbashkët detyrën e garantimit të supremacisë së Kushtetutave të tyre respektive mbi të gjitha ligjet e tjera.

IV. Duke marrë në konsideratë se ty dyja institucionet bëjnë pjesë në Konferencën e Gjykatave Kushtetuese Europiane dhe Konferencën Botërore për Drejtësinë Kushtetuese dhe bashkëpunojnë brendaj këtyre organizmave.

V. Për këto arsyе Palët dëshirojnë të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi në përputhje me sa më poshtë:

KLAUZOLAT

NJË: OBJEKTI. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është ngritja dhe zhvillimi i një kuadri bashkëpunimi midis Gjykatës Kushtetuese të Mbretërisë së Spanjës dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

DY: MARRËVESHJET E PALËVE. Për të arritur qëllimin e mësipërm, Palët mund të bien dakord të zhvillojnë aktivitete me interes të përbashkët që lidhen me juridikcionet e tyre respektive, sikurse janë ndarja e informacionit dhe

dokumentacionit për çështjet ligjore, jurisprudanca dhe materialet kërkimore, bashkëpunimi reciprok për publikimet, dhënia e këshillave teknike dhe zhvillimi i seminareve, konferencave dhe veprimtarive të tjera të ngjashme që nxisin bashkëpunimin midis anëtarëve të tij dyja institucioneve.

TRI: ANGAZHIMET E PUNONJËSVE DHE VIZITAT STUDIMORE. Si Gjykata Kushtetuese e Mbretërisë së Spanjës ashtu edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë mund që brenda fushës së veprimit të kësaj Marrëveshjeje të autorizojnë angazhime dhe vizita studimore të punonjësve të tyre. Këto angazhime apo vizita studimore nuk mund të ndryshojnë në asnjë rrëthanë marrëdhënien ligjore ndërmjet punonjësve në fjalë apo institucioneve përkatëse. Pjesëmarrësit janë të detyruar të respektojnë rregulloren e brendshme të institucionit pranë të cilit zhvillohet aktiviteti.

KATËR: MUNGESA E DETYRIMEVE FINANCIARE. Kjo Marrëveshje nuk nënkupton asnjë detyrim finansiar ndërmjet Palëve, të cilat do të përballojnë shpenzimet e çdo aktiviteti që do t'ju kërkohet.

PESË: MONITORIMI. Me qëllim lehtësimin e planifikimit dhe organizimit të veprimtarive të veçanta do të ngrihet një Komitet Monitorues, i cili do të përbëhet nga:

- a) Përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese të Mbretërisë së Spanjës, Sekretari i Përgjithshëm
- b) Përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Sekretari i Përgjithshëm

GJASHTË: AFATI. Afati i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të jetë tri vjet nga data e nënshkrimit të saj, afat i cili mund të zgjatet nëpërmjet një marrëveshjeje paraprake me shkrim të palëve.

Secila prej Palëve mund ta ndërpresë në mënyrë të njëanshme këtë Marrëveshje me njoftim me shkrim tri muaj para. Gjithësesi, kjo ndërprerje e njëanshme nuk mund të prekë aktivitetet tashmë të miratuara, por ende të pazhvilluara, për aq kohë sa nuk është rënë dakord ndryshe.


SHTATË: MOSMARRËVESHJET. Kjo Marrëveshje nuk është subjekt i të drejtës ndërkombëtare dhe nuk sjell detyrime ligjore. Për këtë arsy, Gjykata Kushtetuese e Mbretërisë së Spanjës dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë marrin përsipër të zgjidhin në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje që mund të lind gjatë përbushjes së saj.

Për sa më sipër, kjo Marrëveshje nënshkruhet nga të dyja Palët në dy kopje të barazvlefshme.

Cándido Conde-Pumpido Tourón

Kryetar

i Gjykatës Kushtetuese të
Mbretërisë së Spanjës



Holta Zaçaj

Kryetar
i Gjykatës Kushtetuese
të Republikës së Shqipërisë

